



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
SENATI AKADEMIK

Nr 2525 prot

Shkodër, më 17.07.2019

V E N D I M

Nr 248, datë 17.07.2019

"PËR MIRATIMIN E RREGULLORES SË ZYRËS SË EKSELENCËS"

Në mbështetje të Ligjit nr. 80, dt 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 37 pika 1, neni 38 pika 1/d, Statutit të USH-së neni 17 pika 1, pika 6/r, dhe me propozim të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit (Shktesë nr.2493, datë 17.07.2019), Senati Akademik i Universitetit të Shkodrës "Luigj Gurakuqi" në mbledhjen e tij të datës 17.07.2019

V E N D O S I

1. Miratimin e e Rregullores së Zyrës së Ekselencës (bashkëlidhur këtij vendimi)
2. Ngarkohen Zv.Rektori, Drejtorja e Kurrikulave, kërkimit shkencor dhe standardeve, Dekani i Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I SENATIT

Prof.dr.Adem BEKTESHI





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Senati Akademik

RREGULLORE E ZYRES SE EKSELENCES

Korrik 2019

Kreu I

Organizimi i Zyrës së Ekselencës

Zyra e Ekselencës veprimtarinë e saj e mbështet në ligjin nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe në Statutin e Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi” datë 02.03.2018, kreu II, neni 8 pika 1/c, neni 13.

Misioni i Zyrës së Ekselencës është mbi të gjitha cilësisë së mësimdhënies dhe kërkimit shkencor në Universitetin e Shkodrës.

Zyra e Ekselencës drejtohet nga përfaqësues të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

Zyra Ekselencës ka si qëllim kryesor të zhvillojë këto aktivitete:

- Trajnime të pedagogëve të rinj mbi metodat e mësimdhënies dhe të pedagogëve me eksperiencë mbi të rejat në fushën e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.
- Trajnim të përfaqësuesve të institucioneve publike mbi metodat e reja menexheriale dhe aftësitë komunikative.
- Trajtime me tema të gjera ndaj komuniteteve të veçanta në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, arsimit dhe shkencës.

Zyra e Ekselencës është një qendër bashkëkohore për trajnimin e stafit akademik të brendshëm dhe të jashtëm të Universitetit të Shkodrës. Ajo ofron module trajnimi ku mund ta gjejnë veten shumica e pedagogëve të angazhuar në USH, në drejtim të sigurimit dhe rritjes së cilësisë së mësimdhënies, përsosjen e saj, zbatime të risive në fushën e mësimdhënies etj.

Zyra e Ekselencës siguron një bashkëpunim të vazhdueshëm me Departamentet e Universitetit të Shkodrës për evidentimin e kërkesave dhe nevojave trajnuese që ato kanë. Po ashtu, ajo bashkëpunon dhe me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit, të cilat ushtrojnë veprimtari të ngjashme në këto fusha.

Zyra e Ekselencës synon të vendos marrëdhënie bashkëpunimi dhe shkëmbim përvoja me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë Shqipërisë.

Zyra e Ekselencës ndodhet në Godinën e re të Fakultetit Ekonomik (kati i pestë), e cila ka një infrastrukturë moderne për zhvillimin e aktiviteteve trajnuese dhe është pjesë e Fakultetit

Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit. Trajnues janë pedagogë të kualifikuar dhe me përvojë mësimdhënieje nga departamentet e Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit, sipas profileve që mbulojnë.

Bordi Drejtues i Zyrës së Ekselencës ka në përbërje të tij:

1. Dekanin e Fakultetit Ekonomik
2. Dekanin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit
3. Përfaqësues të Fakultetit Ekonomik
4. Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave të Edukimit
5. Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave Shoqërore
6. Përfaqësues të Fakultetit të Shkencave të Natyrës
7. Përfaqësues të Fakultetit Juridik
8. Përfaqësues të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja
9. Përfaqësues i Drejtorisë së Kurrikulave, Standardeve, Kërkimit Shkencor dhe Sigurimit të Cilësisë

Drejtimi i kësaj zyre bëhet me rotacion një vjeçar nga përfaqësues të Fakultetit Ekonomik dhe Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

Bordi drejtues shqyrton aktivitetin dhe merr vendime të cilat janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit të universitetit dhe synon që përveç trajnimeve të pedagogëve të rinj të realizojë trajnime për studentët diplomantë, departamentet e USH dhe komunitete të veçanta në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, arsimit dhe shkencës.

Vendimet miratohen me shumicë votash dhe dalin me fuqinë e Dekanit të Fakultetit Ekonomik dhe Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

Drejtuuesi i Zyrës së Ekselencës kujdeset për menaxhimin e saj dhe zbatimin e vendimeve të miratuara nga Bordi Drejtues.

Kreu II

Zhvillimi i vazhdueshëm akademik dhe shkencor

1. Veprimtaria e Zyrës së Ekselencës e mbështet veprimtarinë e saj në Udhëzimin nr. 1, datë 20.01.2017, për "Funksionimin e Sistemit të Zhvillimit të Vazhdueshëm Profesional të Punonjësve Arsimorë" dhe në Ligjin 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Republikën e Shqipërisë".
2. Universiteti i Shkodrës planifikon zhvillimin profesional të stafit akademik, sipas nevojave të tyre dhe në përputhje me politikat qendrore, vendore dhe të USH.

3. Format e zhvillimit profesional janë: zhvillimi i brendshëm profesional, trajnimet, rrjetet profesionale, këshillimet, kurset afatshkurtra dhe ato afatgjata.

Kreu III

Tarifat e pjesëmarrjes dhe shpërndarja e të ardhurave financiare

Tarifa e pjesëmarrjes dhe shpërndarja e të ardhurave financiare janë propozuar duke u mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në IAL në republikën e Shqipërisë”, neni 109, pika 2; VKM Nr 329, datë 12.04.2017, “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, pika 11.; udhëzimin nr 1, dt 20.01.2017, për “Fuksionimin e sistemit të zhvillimit të vazhdueshëm profesional të punonjësve arsimore” neni 6, pika 4; Vendimi i Bordit të Administrimit për “Tarifat e Shkollimit” të USH.

1. Përjashtohen nga tarifa pedagogët e rinj dhe stafi akademik i USH.
2. Tarifa për pjesëmarrje në trajnime të komuniteteve të veçanta jashtë Universitetit të Shkodrës përcaktohet çdo vit akademik me vendim të Bordit të Administrimit të USH.
3. Numri minimal i pjesëmarrësve në trajnime duhet të jetë jo më pak se 10 .
4. Tarifa paguhet në banka të nivelit të dytë ose në çdo Filial i Postës Shqiptare.
5. Shërbimet që ofron Zyra e Ekselencës (literatura, printime, fotokopje, shkarkime nga interneti etj.) janë falas për pjesëmarrësit.
6. Shpërndarja e të ardhurave për pedagogët trajnues të komuniteteve të veçanta bëhet çdo vit akademik me vendim të Bordit të Administrimit të USH që i propozohet nga Senati Akademik.
7. Pagesa e pedagogëve trajnues të stafit të USH bëhet bëhet çdo vit akademik me vendim të Bordit të Administrimit të USH që i propozohet nga Bordi Drejtues i Zyrës së Ekselencës.
8. Drejtuesit të Zyrës së Ekselencës i reduktohet ngarkesa vjetore me 50 orë për punën e bërë pranë kësaj zyre.

Kreu IV

Realizimi i trajnimeve

1. Përgjegjësi i Zyrës së Ekselencës mban lidhje me Departamentet e USH, Drejtorinë e Kurrikulave, Standardeve, Kërkimit Shkencor dhe Sigurimit të Cilësisë , Zyrën e Dekanit të studentëve për evidentimin e nevojave për trajnime.
2. Bordi drejtues i Zyrës së Ekselencës, çdo vit akademik përcakton aktivitetet trajnuese që do të zhvillojë si dhe përcakton personat përgjegjës për secilin aktivitet. Në varësi të tyre përcaktohen modulet, periudha dhe oraret e zhvillimit të trajnimeve.
3. Njoftimi për sesionet e trajnimeve i dërgohet Zyrës së IT të USH për publikim në faqen zyrtare të USH.
4. Trajnimet zhvillohen në sesione të rregullta gjatë vitit akademik sipas një grafiku që i dërgohet çdo Fakulteti të USH.
5. Forma e trajnimit për të gjitha modulet janë: trajnim i drejtpërdrejtë (konsultime, bashkëbisedime), online (njoftimet, literatura, pyetjet etj.)
6. Në fund të trajnimit, pjesmarrësit pajisen me çertifikatë pjesmarrjeje e firmosur nga Dekani i Fakultetit Ekonomik dhe Dekani i Fakultetit të Shkencave të Edukimit.

